




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË - KOSOVË, KOSOVO POLJE



Në bazë të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për Aktivitete jashtëshkollore me nr. 02/2016 të datës 12.01.2016; Gjimnazi "Hivzi Sulejmani" në Fushë - Kosovë, shpallë:

Ftesë për ofertë: Realizimi i ekskursionit për nxënësit maturant

Ftohen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë "Agjenci udhëtimi" apo "Operator turistik", që të marrin pjesë në realizimin e ekskursionit për 223 maturantët e Gjimnazit "HIVZI SULEJMANI" në Fushë - Kosovë

- Në ofertë të parashihet çmimi i cili përfshinë transportin, akomodimin në hotel, ushqimin cilësor e kalorik, sigurinë fizike të nxënësve, shërbimin 24 orësh mjekësor dhe shpenzimet e tjera që paraqiten me rastin e vizitave në vende dhe qytete historike.
- Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) pansione të plota, në ditën e pestë (5) kthimi,
- Realizimi i ekskursionit më datë, 14.10.2024 deri 18.10.2024.

"Agjencionet e udhëtimit" në ofertën e tyre duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Agjencioni të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit,
2. Autobuset të jenë komfor, me klimë dhe WFI,
3. Agjencioni të ketë kontrollimin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike (Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për të gjithë autobusët që do të përdoren në bartjen e nxënësve maturant),
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës (ekskursionit) dhe dëshmi të shërbimit teknik,
5. Agjencioni duhet të ketë dëshmitë (fotokopje) librezat e autobusave,
6. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferave) të autobusave,
7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje dhe shërbimin mjekësor për të gjithë nxënësit, që nga nisja, kohëzgjatja dhe mbyllja e ekskursionit, pastaj dëshminë e certifikatës dhe kontratën e punës së mjekut të angazhuar,
8. Rezervimi i hotelit më dëshmi origjinale e të vulosur dhe në bashkëpunim me hotelin të ofrojë sigurim 24 orësh për nxënësit dhe personelin përcjellës,
9. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit).

Afati i paraqitjes së ofertave me të gjithë dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare (Web) të Komunës së Fushë - Kosovës.

Dorëzimi i ofertave: Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur deri më datën 3 tetor 2024 në adresën: Gjimnazi "Hivzi Sulejmani" në Fushë-Kosovë, rruga "Aziz Zhilivoda" nr.23. Hapja e ofertave bëhet më datën 3 tetor 2024 (e enjte) nga ora 14:00 nga Komisioni pa praninë e ofertuesve. Agjencioni apo ofertuesi i përzgjedhur do të njoftohet përmes mjeteve të komunikimit nga zyrtarët e shkollës.

Fushë - Kosovë, më 25.09.2024

Drejtori i shkollës: Msc. Amir Pllana

